

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"HappyHerbs"

Më datë **02.09.2024**, mbështetur në ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, dhe akte të tjera ligjore e nënligjore, në cilësinë e Ortakut të Vetëm themelues **Z. Ardit Muça shtetas Shqiptar, lindur më 14-06-1982 në Elbasan dhe banues në Rrugen Panajot Pano, Nd. 1, Kashar, Yzberisht, Tiranë person madhor me zotësi juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit Nr.037943908 dhe Nr. personal I20614051D** deklaron se ka vendosur të nënshkruajë këtë kontratë themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë referuar si shoqëria), me termat e mëposhtëm.

Neni 1
Emërtimi

Shoqëria emërtohet "**HappyHerbs**" **SH.P.K.** Emërtimi i shoqërisë mund të shkruhet me shkronja të mëdha ose të vogla.

Neni 2
Selia

Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet në në Lagjen "Barrikadë" Berat, Rruga Ish Ushqimore, godinë tre katëshe, zona kadastrale nr.8501 me nr.pasurie 4/416.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit Tiranë. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Neni 4
Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

- **Paketimi dhe përpunimi i bimëve medicinale, erëzave, çajrave dhe vajrave esenciale. Tregëtimi dhe import eksporti i tyre.**
- **Transport kombëtar dhe ndërkombëtar i mallrave për vete e të tretë.**



Shoqëria mundet të realizoj çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brënda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 5
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 800,000 (tetëqindmijë) lekë.
Kapitali themeltar është i përbërë nga 1 (një) kuotë kapitali me vlerë të përgjithshme 800,000 (tetëqindmijë) lekë dhe zotërohet nga Ortaku i Vetëm Z. Ardit Muça.

Neni 6
Kontributet e Kapitalit themeltar

Derdhja e kapitalit themeltar është bërë në masën dhe mënyrën e mëposhtëme:

- Z. Ardit Muça ka kontribuar në para në shumën 800,000 (tetëqindmijë) lekë.

Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin themeltar të shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij si më poshtë:

- Z. Ardit Muça është zotërues i 1(një) kuotë kapitali me vlerë të përgjithshme 800,000 (tetëqindmijë) lekë ose 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 7
Kuotat dhe kalimi i kuotave të kapitalit

Zotërimi i kuotave, mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave, pjesëtimi dhe transferimi i tyre do të bëhen sipas procedurave të parashikuara në ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe nga statuti i shoqërisë.

Neni 8
Administrimi

Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator persona fizikë, qofshin këta edhe jo ortak të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori/ët qendrojnë në postin e tyre për pesë vjet financiarë, me mundësinë për tu rizgjedhur. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo statuti i jep Asamblesë duke përfshirë delegimin e kompetencave edhe personave të tjerë me prokurë të posaçme.

Administratori i parë i shoqërisë është z. Ardit Muça shtetas Shqiptar, lindur më 14-06-1982 në Elbasan dhe banues në Rrugen Panajot Pano, Nd. 1, Kashar, Yzberisht, Tiranë person madhor me zotësi juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit Nr.037943908 dhe Nr. personal I20614051D. Mandati i administratorit

fillon në datë 02.09.2024 dhe mbaron në datë 01.09.2029 me të drejtë për tu rizgjedhur. Ai do të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB). Të gjitha shpenzimet që do të kryen deri në regjistrimin e shoqërisë si person juridik do të përfshihen në bilancin e shoqërisë.

Neni 9 Të tjera

Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Kushtet e punës, shpërblimet, oraret, pushimet dhe sigurimet shoqërore të personelit do të rregullohen nga kontrata kolektive ose ajo individuale e punës, si dhe nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Neni 10 Kundërshtimet

Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj midis ortakëve ose një ose më shumë ortakëve dhe shoqërisë do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë midis të interesuarëve për ti zgjidhur miqësisht. Në rast të kundërt i nënshtrohen juridiksionit të Gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

Neni 11

Ky Akt Themelimi është përgatitur në katër kopje të barazvlerëshme në gjuhën shqipe.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË “HappyHerbs” SH.P.K.

ARDIT MUÇA

Ardit Muça

